



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:243559

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05814514

C.nr.6718/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditësve: 1) R.C, 2) SH.F, 3) XH.O, 4) RR.B, 5) G.M dhe 6) G.D, të përfaqësuar në bazë të autorizimit nga M.A, avokat me seli në P, kundër të paditurës “N.B” Sh.a, me seli në P, Rr. “U.H” nr..., e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga SH.K dhe E.G, me objekt kontesti anulimin e vendimeve mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kompensimin e të ardhurave personale, vlera e kontestit 79,411.00 €, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor - publik në riprocedim, me datë 29.05.2024, në prezencën e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, me datë 11.06.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRËSI si e bazuar kërkesëpadia e paditësve R.C, SH.F, XH.O, RR.B, G.M dhe G.D, ashtu që:

ANULOHEN si të kundërligjshme vendimet e Kryetarit të Bordit Udhëheqës të të paditurës Nr.3862, 3863, 3864, 3865, 3866 dhe 3867, të dt.30.09.2009, me të cilat paditësve R.C, SH.F, XH.O, RR.B, G.M dhe G.D u është ndërprerë marrëdhënia e punës, si dhe vendimet e Këshillit Drejtues të të paditurës, nr.4220, 4221, 4222, 4223, 4224 dhe 4225, të dt.30.10.2009, me të cilat janë refuzuar si të pa bazuara ankesat e paditësve dhe janë vërtetuar vendimet e shkallës së parë.

II. DETYROHET e paditura “N.B” sh.a, me seli në P, që paditësve R.C, SH.F, XH.O, RR.B, G.M dhe G.D, secilit veç e veç, në emër të pagave të pa paguara, kontributit pensional dhe tatimit në të ardhura gjatë periudhës kohore nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, dt.01.10.2009, e deri me datë 30.06.2011, t’ua paguajë shumat si në vijim:

a) - Paditësit R.C, në emër të pagave neto për periudhën kohore 01.10.2009 -30.06.2011, shumën prej 7,431.00 € (shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e një euro), si dhe kamatës së arritur për pagesë për këto paga, duke e llogaritur nga data 04.11.2009, e deri me dt.15.07.2019, për normën si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar shumën prej 1,629.00 € (një mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë euro), apo shumën e përgjithshme prej 9,060.00 € (nëntë mijë e gjashtëdhjetë euro).

-Në emër të kontributit pensional, shumën prej 824.00 € (tetëqind e njëzet e katër euro), mjete këto të cilat duhet të transferohen në llogarinë personale të paditësit R.C në Trustin Pensional të Kosovës;

-Në emër të tatimit në të ardhura, shumën prej 401.00 € (katërqind e një euro), e cila shumë duhet të deklarohet pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

b) - Padiësit SH.F, në emër të pagave neto për periudhën kohore 01.10.2009 - 30.06.2011, shumën prej 9,285.00 € (nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë euro), si dhe kamatës së arritur për pagesë për këto paga, duke e llogaritur nga dt.04.11.2009, e deri me dt.15.07.2019, për normën si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar shumën prej 1,956.00 € (një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro), apo shumën e përgjithshme prej 11,241.00 € (njëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e një euro).

-Në emër të kontributit pensional, shumën prej 1,032.00 € (një mijë e tridhjetë e dy euro), mjete këto të cilat duhet të transferohen në llogarinë personale të padiësit SH.F në Trustin Pensional të Kosovës;

-Në emër të tatimit në të ardhura, shumën prej 517.00 € (pesëqind e shtatëmbëdhjetë euro), e cila shumë duhet të deklarohet pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

c) - Padiësit XH.O, në emër të pagave neto për periudhën kohore 01.10.2009 - 30.06.2011, shumën prej 9,285.00 € (nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë euro), si dhe kamatës së arritur për pagesë për këto paga, duke e llogaritur nga data 04.11.2009, e deri me dt.15.07.2019, për normën si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar shumën prej 1,956.00 € (një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro), apo shumën e përgjithshme prej 11,241.00 € (njëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e një euro).

-Në emër të kontributit pensional, shumën prej 1,032.00 € (një mijë e tridhjetë e dy euro), mjete këto të cilat duhet të transferohen në llogarinë personale të padiësit XH.O në Trustin Pensional të Kosovës;

-Në emër të tatimit në të ardhura, shumën prej 517.00 € (pesëqind e shtatëmbëdhjetë euro), e cila shumë duhet të deklarohet pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

d) - Padiësit RR.B, në emër të pagave neto për periudhën kohore 01.10.2009 – 30.06.2011, shumën prej 9,345.00 € (nëntë mijë e treqind e dyzet e pesë euro), si dhe kamatës së arritur për pagesë për këto paga, duke e llogaritur nga data 04.11.2009, e deri me dt.15.07.2019, për normën si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar shumën prej 1,971.00 € (një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një euro), apo shumën e përgjithshme prej 11,316.00 € (njëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë euro).

-Në emër të kontributit pensional, shumën prej 1,039.00 € (një mijë e tridhjetë e nëntë euro), mjete këto të cilat duhet të transferohen në llogarinë personale të padiësit RR.B në Trustin Pensional të Kosovës;

-Në emër të tatimit në të ardhura, shumën prej 522.00 € (pesëqind e njëzet e dy euro), e cila shumë duhet të deklarohet pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

e) - Padiësit G.M, në emër të pagave neto për periudhën kohore 01.10.2009 – 30.06.2011, shumën prej 4,898.00 € (katërmijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë euro), si dhe kamatës së arritur për pagesë

për këto paga, duke e llogaritur nga data 04.11.2009, e deri me dt.15.07.2019, për normën si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar shumë prej 1,094.00 € (një mijë e nëntëdhjetë e katër euro), apo shumë e përgjithshme prej 5,992.00 € (pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy euro).

-Në emër të kontributit pensional, shumë prej 537.00 € (pesëqind e tridhjetë e shtatë euro), mjete këto të cilat duhet të transferohen në llogarinë personale të paditësit G.M në Trustin Pensional të Kosovës;

-Në emër të tatimit në të ardhura, shumë prej 205.00 € (dyqind e pesë euro), e cila shumë duhet të deklarohet pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

f) - Paditësit G.D, në emër të pagave neto për periudhën kohore 01.10.2009 - 30.06.2011, shumë prej 9,385.00 € (nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e pesë euro), si dhe kamatës së arritur për pagesë për këto paga, duke e llogaritur nga data 04.11.2009, e deri me dt.15.07.2019, për normën si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar shumë prej 1,981.00 € (një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një euro), apo shumë e përgjithshme prej 11,366.00 € (njëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro).

-Në emër të kontributit pensional, shumë prej 1,043.00 € (një mijë e dyzet e tre), mjete këto të cilat duhet të transferohen në llogarinë personale të paditësit G.D në Trustin Pensional të Kosovës;

-Në emër të tatimit në të ardhura, shumë prej 526.00 € (pesëqind e njëzet e gjashtë euro), e cila shumë duhet të deklarohet pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

III. DETYROHET e paditura “N.B” sh.a, me seli në P, që paditësve R.C, SH.F, XH.O, RR.B, G.M dhe G.D, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguajë shumë e përgjithshme prej 5,297.00 € (pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë euro), dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

- Rrjedha e procedurës dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse -

Paditësit R.C, SH.F, XH.O, RR.B, G.M dhe G.D, përmes përfaqësuesit të autorizuar M.A, avokat në P, me dt.04.11.2009 kanë parashtruar padi pranë ish - Gjykatës Komonale në Prishtinë kundër të paditurës “N.B” Sh.a, me seli në P, me objekt kontesti anulimin e vendimeve mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kompensimin e të ardhurave personale. Në referatin e padisë ndër tjera pretendohet se paditësit kanë qenë në marrëdhënie pune pranë të paditurës, ndërsa kjo e fundit, me vendimet përfundimtare nr.3863, 3864, 3865, 3866 dhe 3867, të dt.30.09.2009, në mënyrë të njëanshme ua ka shpëputur kontratat e punës, të cilat ishin të lidhura për periudhën kohore 01.07.2008 - 30.06.2011. Tutje pretendohet se kundër këtyre vendimeve, paditësit brenda afatit ligjor kanë paraqitur ankesa, të cilat janë refuzuar nga e paditura sipas vendimit nr.4221, të dt.30.10.2009. Paditësit pretendojnë që e paditura nuk i ka marrë parasysh vërejtjet dhe arugmentet e parashtrura në ankesat e paditësve lidhur me faktin se marrëdhënia e tyre e punës është themeluar për afat 3 vjeçar, dhe atë për 5 paditësit e parë, duke filluar nga data 01.07.2008 e deri me dt.30.06.2011, ndërsa për

paditësin e gjashtë, duke filluar nga data 30.04.2009, e deri me dt.30.06.2011. Më tej pretendohet se e paditura me vendimet e sipërcekura ua ka ndërprerë paditësve marrëdhënien e punës kundër vullnetit të tyre, pa njoftim paraprak me shkrim, pa planifikim paraprak të organizimit në strukturë dhe në teknologji, të cilat kërkojnë zvogëlimin e numrit të punëtorëve, pa e marrë parasysh stazhin e tyre të punës, efektshmërinë në punë dhe pa u paguar dëmshpërblim të njëkohshëm për shkëputjen e marrëdhënies së punës. Paditësit te e paditura marrëdhënien e punës e kanë themeluar vite më parë dhe këtë marrëdhënie e kanë vazhduar me sukses, pas asnjë vërejtje, me kontrata të kohë pas kohshme, por pa e ndërprerë asnjëherë marrëdhënien e punës deri në vendimet e sipërcekura të datës 30.09.2009. Nga kjo rezulton se paditësit kanë realizuar stazh të pa ndërprerë te e paditura dhe atë: R.C, 7 vite e 6 muaj; SH.F, 4 vite e 7 muaj; XH.O, 7 vite; RR.B, 6 vite e 6 muaj; G.M, 6 vite e 11 muaj dhe G.D, 5 vite e 8 muaj. Tutje pretendohet se e paditura, me rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës është dashur t'ua paguajë dëmshpërblimin e njëkohshëm e në përputhje me nenin 12 pika dh) të Ligjit Themelor të Punës, Rregullorja Nr.2001/27. Mbi këtë bazë, pretendohet se edhe vendimet e nxjerra nga e paditura janë në kundërshtim me nenin 12 të kësaj Rregullore. Bazuar në këto pretendime, ka propozuar që të vendoset si në petitum të kërkesëpadisë.

E paditura, përmes përgjigjes në padi, të deponuar në Gjykatë me dt.31.03.2010, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve. Fillimisht pretendohet se vendimet mbi shkëputjen e marrëdhënies së punës janë të bazuara në ligj, respektivisht në dispozitën nga neni 12.1 të Rregullores Nr.2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë. Tutje pretendohet se nuk është kontestues fakti që paditësve u është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale dhe mbi këtë bazë nga njëra anë paditësit kërkojnë që të vërtetohet se vendimet e të paditurës janë të kundërligjshme, e në anën tjetër kompensimin që duhet të paguhet me rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës. Në këtë mënyrë pretendohet se nëse vërtetohet që vendimet e të paditurës janë të kundërligjshme, paditësve nuk u takon kompensimi. Më tej pretendohet se paditësve nuk u takon kompensim bazuar edhe në faktin se nuk është plotësuar kushti nga fjalia e dytë e nenit 12.1 të Rregullores së lartëcekur, për arsye se nuk kemi të bëjmë me largim masiv nga puna, por marrëdhënia e punës u është ndërprerë 6 punëtorëve për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale, ndërsa largim masiv konsiderohet largimi i të paktën 50 punëtorëve. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, është propozuar që kërkesëpadija e paditësve të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Gjykata Komunale në Prishtinë, me aktgjykimin C.nr.2478/2009, të dt.25.05.2010, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, ndërsa Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me aktvendimin Ac.nr.991/2010, të dt.30.11.2011, e ka prishur aktgjykimin e lartëcekur, duke e kthyer çështjen në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin C.nr.2933/11, të dt.27.11.2014, e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës, përmes aktvendimit Ac.nr.1580/2015, të dt.05.04.2018, e ka anuluar aktgjykimin e lartëcekur, duke e kthyer çështjen në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin C.nr.1182/18, të dt.11.10.2019, e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës, përmes aktvendimit Ac.nr.4395/20, të dt.02.11.2023, e ka anuluar aktgjykimin e lartëcekur, duke e kthyer çështjen në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata në kuptim të vërejtjeve dhe udhëzimeve të dhëna përmes aktvendimit të lartëcekur të Gjykatës së Apelit, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën përgaditore me dt.12.03.2024, si dhe seancat e shqyrtimit kryesor me dt.15.04.2024 dhe 29.05.2024.

Në riprocedim, i autorizuari i paditësve, ndër tjera ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë nën shenjën C.nr.2478/09, pretendimeve nga gjykimet e mëhershme, duke shtuar se tërhiqet nga pjesa e kërkesëpadisë e cila është refuzuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1182/18, të dt.11.10.2019, respektivisht e cila ka mbetur e pa shqyrtuar në bazë të aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4395/20, të dt.02.11.2023. Tutje ka theksuar se i konteston provat e bashkangjitura nga pala e paditur dhe atë: 1) Elaboratin e arsyeshmërisë ekonomike për angazhimin e kompanisë së jashtme për sigurim në N sh.a në P, i datës 22.10.2008; 2) Marrëveshjen për rregullimin e marrdhënieve me rastin e marrjes së punëtorëve gjatë bartjes-transferimit të punëve të datës 30.09.2009 dhe 3) Ekstraktin e procesverbalit të datës 15.09.2009. Thelbi i pretendimeve të të autorizuarit të paditësve qëndron në faktin se provat e lartëcekura janë të pa pranueshme, fiktive dhe të paraqitura pas afateve të parapara ligjore, duke shtuar se të njejtat përmbajnë edhe elemente të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve. Më tej ka pretenduar se nga provat e administruara në tri procedurat e mëhershme është argumentuar se kërkesëpadia është e bazuar dhe se vendimet e të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës janë të kundërligjshme, andaj paditësve u takon e drejta në kompensimin e pagave dhe kompensimet tjera sipas lartësisë së përcaktuar në ekspertizë financiare. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar, dhe atë: shpenzimet e krijuara nga gjykimet e mëhershme në shumën prej 4,892.80 Euro, si dhe shpenzimet e krijuara në këtë procedurë.

Në riprocedim, pala e paditur, përmes përfaqësuesit të autorizuar ndër tjera ka deklaruar se mbeten pranë përgjigjes në padi, thëniet verbale nga seancat e kaluara si dhe të gjitha shkresave në këtë çështje kontestimore, duke shtuar se qëndrojnë pranë pretendimit që padia është e pas afatshme, për faktin se nuk është paraqitur brenda afatit prej 45 ditëve. Tutje ka theksuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me largim masiv nga puna, të paraparë me Rregulloren Nr.2001/27 të Ligjit Themelor të Punës në atë kohë, por me largim të 7 të punësuarve, ku 6 prej tyre kanë parashtruar padi dhe neni 12 pika 1 e Rregullores së lartpërmendur zbatohet vetëm në rastet kur ka të bëjë me largimin e 50 punonjësve. Më tej pretendohet se vendimet janë nxjerrë në bazë të nenit 11 pika 7 të Ligjit të Punës në atë kohë, kjo bazuar në faktin se pjesës tjetër të të punësuarve nuk u është ndërprerë kontrata e punës, por u është ofruar kontratë pas skadimit të kontratave aktuale. Tutje ka kërkuar nga Gjykata që neni 12 të mos merret për bazë, për faktin se asnjë dispozitë ligjore apo akt i të paditurës nuk e ka obliguar që të dërgohet elaborati të punësuarve për arsyet e ndërprerjes së kontratës së punës. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pa bazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

- Gjendja faktike e vërtetuar mbi bazën e provave të administruara -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.29.05.2024, gjatë procedurës së administrimit të provave, ka administruar provat materiale të administruara nga procesverbalet e përpiluara në Gjykatën Komunale në Prishtinë, C.nr.2478/09, të dt.25.05.2010; procesverbali i përpiluar në

Gjykatën Themelore në Prishtinë, C.nr.2933/11, i dt.01.09.2014; procesverbali i përpiluar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, C.nr.1182/18, i dt.11.10.2019 dhe atë:

Kontratat e punës për paditësit R.C, SH.F, XH.O, RR.B, G.M, G.D, Nr.2258, e dt.24.06.2008; Nr.2255, e dt.24.06.2008; Nr.2132, e dt.23.06.2008; Nr.2257, e dt.24.06.2008 dhe Nr.2256, e dt.25.06.2008; Vendimet e të paditurës, të nxjerra nga Kryetari i Bordit Udhëheqës Nr.3862, 3863, 3864, 3865, 3866 dhe 3867, të dt.30.09.2009; Ankesat e paditësve Nr.3996, 3999, 3998, 4001, 3997, 4000, të dt.09.10.2009; Vendimet e të paditurës, të nxjerra nga Këshilli Drejtues, Nr.4220, 4221, 4222, 4223, 4224 dhe 4225, të dt.30.10.2009; Aktvendimi i Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës Nr.4471, i dt.24.11.2009; Marrëveshja nr.3874, e dt.30.09.2009 për rregullimin e marrëdhënieve me rastin e marrjes së punëtorëve gjatë bartjes-transferimit të punëve, të lidhur ndërmjet këtu të paditurës “N.B” dhe “B.I”; Ekstrakti i procesverbalit të përpiluar nga e paditura (i pa nënshkruar dhe pa protokolluar); Elaborati mbi arsyeshmërinë ekonomike i dt.24.10.2008 dhe Ekspertiza nga lëmia e aktuaristikës, e përpiluar me dt.25.07.2019 nga eksperti Prof. A.B.

Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, me ç’rast ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nga provat e administruara, Gjykatës i rezulton se fillimisht mes palëve ndërgjyqëse nuk rezulton të jetë kontestues fakti së paditësit kanë qenë në marrëdhënie pune pranë të paditurës dhe atë:

Paditësi R.C, sipas kontratës së punës Nr.2258, të lidhur me datë 24.06.2008. Në nenin 1 të kësaj kontrate është përcaktuar se paditësi i lartëcekur sistemohet në vendin e punës “...”, në njësinë organizative “...”, me pagë mujore bruto në vlerë prej 520.00 €. Në nenin 2 të kësaj kontrate është specifikuar se marrëdhënia e punës sipas kësaj kontrate lidhet për kohë të caktuar, duke filluar nga data 01.07.2008 deri me datë 30.06.2011.

Paditësi SH.F, sipas kontratës së punës Nr.2255, të lidhur me datë 24.06.2008. Në nenin 1 të kësaj kontrate është përcaktuar se paditësi i lartëcekur sistemohet në vendin e punës “...”, në njësinë organizative “...”, me pagë mujore bruto në vlerë prej 500.00 €. Në nenin 2 të kësaj kontrate është specifikuar se marrëdhënia e punës sipas kësaj kontrate lidhet për kohë të caktuar, duke filluar nga data 01.07.2008 deri me datë 30.06.2011.

Paditësi XH.O, sipas kontratës së punës Nr.2132, të lidhur me datë 23.06.2008. Në nenin 1 të kësaj kontrate është përcaktuar se paditësi i lartëcekur sistemohet në vendin e punës “...”, në njësinë organizative “...”, me pagë mujore bruto në vlerë prej 500.00 €. Në nenin 2 të kësaj kontrate është specifikuar se marrëdhënia e punës sipas kësaj kontrate lidhet për kohë të caktuar, duke filluar nga data 01.07.2008 deri me datë 30.06.2011.

Paditësi RR.B, sipas kontratës së punës Nr.2257, të lidhur me dt.24.06.2008, Në nenin 1 të kësaj kontrate është përcaktuar se paditësi i lartëcekur sistemohet në vendin e punës “...”, në njësinë organizative “...”, me pagë mujore bruto në vlerë prej 500.00 €. Në nenin 2 të kësaj kontrate është specifikuar se marrëdhënia e punës sipas kësaj kontrate lidhet për kohë të caktuar, duke filluar nga data 01.07.2008 deri me datë 30.06.2011.

Paditësi G.M, sipas kontratës së punës Nr.2256, të lidhur me dt.24.06.2008, Në nenin 1 të kësaj kontrate është përcaktuar se paditësi i lartëcekur sistemohet në vendin e punës "...", në njësinë organizative "...", me pagë mujore bruto në vlerë prej 500.00 €. Në nenin 2 të kësaj kontrate është specifikuar se marrëdhënia e punës sipas kësaj kontrate lidhet për kohë të caktuar, duke filluar nga data 01.07.2008 deri me datë 30.06.2011.

Paditësi G.D, sipas kontratës së punës Nr.1396/1, të lidhur me dt.30.04.2009, Në nenin 1 të kësaj kontrate është përcaktuar se paditësi i lartëcekur sistemohet në vendin e punës "...", në njësinë organizative "...", me pagë mujore bruto në vlerë prej 500.00 €. Në nenin 2 të kësaj kontrate është specifikuar se marrëdhënia e punës sipas kësaj kontrate lidhet për kohë të caktuar, duke filluar nga data 01.05.2009 deri me datë 30.06.2011.

Po ashtu, mes palëve ndërgjyqëse nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësve u është ndërprerë marrëdhënia e punës nga e paditura sipas vendimeve individuale për të gjitha paditësit, dhe atë: Paditësit R.C, në bazë të vendimit nr.3863, të dt.30.09.2009, të lëshuar nga Kryetari i Bordit Udhëheqës të të paditurës z.A.L; Paditësit SH.F, në bazë të vendimit nr.3862, të dt.30.09.2009, të lëshuar nga Kryetari i Bordit Udhëheqës të të paditurës z.A.L; Paditësit XH.O, në bazë të vendimit nr.3864, të dt.30.09.2009, të lëshuar nga Kryetari i Bordit Udhëheqës të të paditurës z.A.L; Paditësit RR.B, në bazë të vendimit nr.3865, të dt.30.09.2009, të lëshuar nga Kryetari i Bordit Udhëheqës të të paditurës z.A.L; Paditësit G.M, në bazë të vendimit nr.3866, të dt.30.09.2009, të lëshuar nga Kryetari i Bordit Udhëheqës të të paditurës z.A.L; Paditësit Galib Dedoviç, në bazë të vendimit nr.3867, të dt.30.09.2009, të lëshuar nga Kryetari i Bordit Udhëheqës të të paditurës z.A.L.

Në dispozitivin e të gjitha vendimeve të lartëcekura, është vendosur që kontratat mbi marrëdhënien e punës për secilin prej paditësve, me të dhënat e specifikuara më sipër konsiderohen të shkëputura, duke filluar nga data 01.10.2009. Në arsyetim të këtyre vendimeve, është cekur se vendimi i tillë i Këshillit Drejtues paraqet ndryshim ekonomik, struktural dhe organizativ në Bankë, e që paraqet bazë ligjore për marrjen e këtij vendimi sepse është në pajtim me dispozitën e nenit 12 alineja 1 të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, ku parashihet se kontrata e punës mund të shkëputet nga punëdhënësi për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale. Tutje është theksuar se të gjitha punët profesionale të cekura si më lartë, nga data 1 tetor 2009 do t'i kryejë kompania "B.I", me ç'rast të gjithë punëtorët e sigurimit dhe vozitësit për transportim të cash-it do të kalojnë në kompaninë e specializuar "B.I".

Kundër vendimeve të lartëcekura, paditësit rezulton se kanë parashtruar ankesa në mënyrë individuale, ndërsa e paditura i ka refuzuar ankesat e paditësve përmes vendimeve si në vijim: Përmes vendimit Nr.4221, të dt.30.10.2009, të nxjerrë nga Këshilli Drejtues, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit R.C dhe është vërtetuar vendimi i Kryetarit të Bordit Udhëheqës nr.3863, të dt.30.09.2009; Përmes vendimit Nr.4220, të dt.30.10.2009, të nxjerrë nga Këshilli Drejtues, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit SH.F dhe është vërtetuar vendimi i Kryetarit të Bordit Udhëheqës nr.3862, të dt.30.09.2009; Përmes vendimit Nr.4223, të dt.30.10.2009, të nxjerrë nga Këshilli Drejtues, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit XH.O dhe është vërtetuar vendimi i Kryetarit të Bordit Udhëheqës nr.3864, të dt.30.09.2009; Përmes vendimit Nr.4222, të dt.30.10.2009, të nxjerrë nga Këshilli Drejtues, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit RR.B dhe është vërtetuar vendimi i Kryetarit të Bordit Udhëheqës nr.3865, të dt.30.09.2009; Përmes vendimit Nr.4225, të dt.30.10.2009, të nxjerrë nga Këshilli Drejtues, është refuzuar si e pa bazuar

ankesa e paditësit G.M dhe është vërtetuar vendimi i Kryetarit të Bordit Udhëheqës nr.3866, të dt.30.09.2009; Përmes vendimit Nr.4224, të dt.30.10.2009, të nxjerrë nga Këshilli Drejtues, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit G.D dhe është vërtetuar vendimi i Kryetarit të Bordit Udhëheqës nr.3867, të dt.30.09.2009.

Në arsyetimin e këtyre vendimeve është konstatuar se vendimet e shkallës së parë nuk përmbajnë shkelje të dispozitave të Ligjit Themelor të Punës dhe në rastin e ankuesve nuk mund të aplikohen dispozitat e nenit 12.2 të LTHP-së, për shkak se nuk ka pasur largim të punëtorëve në shkallë të gjerë. Tutje në arsyetim të këtyre vendimeve është cekur se të gjithë ankuesit, përmes emailit të dërguar me dt.04.03.2009 kanë qenë të informuar me elaboratin për arsyeshmërinë ekonomike për angazhimin e kompanisë së jashtme profesionale.

Përmes aktvendimit të Trupit Ekzekutiv të Inspektoaratit të Punës Nr.4471, të dt.24.11.2009, janë refuzuar kërkesat e punëtorëve RR.B, SH.F, N.XH, XH.O, R.C, G.M. G.D, I.Q, G.G, M.G, R.H dhe B.J, lidhur me pretendimin për shkeljen e të drejtave nga marrëdhënia e punës nga këtu e paditura.

Nga marrëveshja nr.3874, e dt.30.09.2009 për rregullimin e marrëdhënieve me rastin e marrjes së punëtorëve gjatë bartjes - transferimit të punëve, të lidhur ndërmjet këtu të paditurës "N.B" dhe "B.I", rezulton që palët në marrëveshje janë pajtuar që subjekti "B.I" të pranojë të gjithë punëtorët të cilët aktualisht janë të sistemuar në punët e sigurimit të objekteve dhe vozitësit e parave të gatshme (cash-it), me kusht që të njejtit i plotësojnë kushtet e veçanta nga legjilacioni i cili mbulon fushëveprimin e industrisë së sigurisë private në Kosovë. Në marrëveshje po ashtu është paraparë që nga ana e punëtorëve të plotësohet aplikacioni në formë dhe përmbajtje të caktuar.

Nga ekstrakti i procesverbalit të përpiluar nga e paditura, është konstatuar se në takimin e Bordit, ku ishin të pranishëm edhe vozitësit e cash-it (këtu paditësit R.C, RR.B, G.M, XH.O) dhe punëtorët e sistemuar në vendin e punës - punëtorë të sigurimit, është diskutuar për procesin e kalimit në kompani, duke e vënë theksin në atë se Banka ka caktuar pikat që punët e transportit të parave të gatshme t'i kryejë kompania e specializuar. Në takimin e mbajtur, është konstatuar se punëtorët e transportimit të cash-it kanë shprehur pakënaqësi për kompaninë "B.I", deri sa kanë theksuar që kompaninë "G" e kanë pranuar pa rezervë, duke kërkuar që sipas mundësive të sistemohen në vende tjera të punës.

Gjykata në kuptim të vërejtjeve të dhëna përmes aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.4395/20, të dt.02.11.2023, ka kërkuar nga ana e palës së paditur që në cilësinë e provës materiale të prezantojë elaboratin mbi arsyeshmërinë ekonomike të dt.24.10.2008, provë kjo e cila është prezantuar nga pala e paditur dhe është administruar në seancën e shqyrtimit kryesor.

Nga elbaorati mbi arsyeshmërinë ekonomike të angazhimit të një kompanie të jashtme për sigurimin e "N" Sh.a, i dt.24.10.2008, në pikën I është propozuar nga Bordi Udhëheqës që të miratojë vendim mbi aprovimin e të njejtit. Tutje në këtë elaborat është konstatuar se në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Aksionarëve të N, ishte parashikuar që punët e sigurimit fizik, gjatë vitit 2008 t'i barten një kompanie të specializuar të sigurimit. Në këtë mënyrë, numri i të punësuarve do të zvogëlohet për rreth 200 punëtorë të sigurimit. Në pikën II të këtij elaborati janë cekur të dhëna lidhur me numrin, strukturën dhe kompensimet e punëtorëve të punësuar të sigurimit, ndërsa në pikën III janë dhënë shpjegime lidhur me qëllimet e angazhimit të një kompanie të jashtme, me ç'rast është

theksuar se që nga themelimi i bankave, ato kanë pasur punëtorë të tyre të sigurimit, të cilët, edhe pse kanë ndjekur kurse për këtë qëllim, nuk janë mjaftueshëm të përgaditur në aspektin profesional. Tutje është cekur se duke angazhuar një kompani të jashtme të sigurimit, do të sigurohet një nivel më i lartë i shërbimeve profesionale dhe më cilësore.

Në kuptim të vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna nga aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4395/20, të dt.02.11.2023, vëmendja e gjykatës së shkallës së parë në riprocedim është përqendruar drejt vlerësimit të faktit nëse e paditura, me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së paditësve, ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 12 të Rregullores Nr.2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë.

- Baza ligjore dhe vlerësimi i Gjykatës -

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të kërkesëpadsisë së paraqitur, duke marrë për bazë natyrën e kontestit, raportin juridik mes palëve ndërgjyqëse, si dhe kohën kur ka lindur ky raport, duhet t'i referohemi Rregullores Nr.2001/27 për Ligjin Themelore të Punës në Kosovë, të shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë me datë 08.10.2001, Rregullore kjo e cila ka gjetur zbatim deri në hyrjen në fuqi të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.11.2010. Dispozita nga neni 1, par.1 e cila i referohet fushëveprimit të kësaj Rregullore përcakton që: *“Kjo rregullore rregullon punësimin në Kosovë, duke përfshirë edhe marrëdhëniet e punës sipas të cilave kryhen punët ose shërbimet”*. Në anën tjetër, dispozita nga neni 9, e cila i referohet palëve në marrëdhënien e punës, në paragrafet 1, 2 dhe 3 përcakton që: *1. Palë në marrëdhënien e punës janë punëdhënësi dhe punonjësi. 2. Punëdhënësi nënkupton personin fizik ose juridik i cili i siguron punë punonjësit dhe i paguan atij ose asaj pagën a rrogën për punën ose për shërbimet e kryera. Punëdhënësi përmbush obligimet dhe ushtron të drejtat e tij në përputhje me ligjin në fuqi, me kontratën e punës dhe, sipas rastit, edhe me marrëveshjen kolektive. 3. Punonjësi nënkupton personin fizik të punësuar për të kryer punë ose shërbime për punëdhënësin nën autoritetin ose kontrollin e këtij të fundit. Punonjësi përmbush obligimet si dhe ushtron të drejtat e tij në përputhje me ligjin në fuqi, me kontratën e punës dhe, sipas rastit, edhe me marrëveshjen kolektive”*. Gjykata po ashtu iu referua edhe dispozitës nga neni 12 të kësaj Rregullore, e cila i referohet shkëputjes së kontratës së punës për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale në ndërmarrje. Paragrafi 1 i kësaj dispozite përcakton që: *“Kontrata e punës mund të shkëputet nga punëdhënësi për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale në ndërmarrje. Ndryshimet e tilla paraqesin rastet kur punëdhënësi bën ndryshime në prodhim, në programim, në organizim, në strukturë dhe në teknologji të cilat kërkojnë zvogëlim të numrit të punonjësve. Në rastet kur për këtë arsye largohen nga puna të paktën 50 punonjës konsiderohet se largimi nga puna është i shkallës së gjerë.”*

Gjykata fillimisht vlerëson se duhet dhënë përgjigje pretendimit të palës së paditur lidhur me një prezumim procedural, e që ka të bëjë afatshmërinë e padsisë së paditësve, respektivisht pretendimit se padia nuk është paraqitur brenda afatit prej 45 ditëve nga dita e pranimit të vendimeve mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Në rastin konkret, Gjykata gjen se Rregullorja Nr.2001/27 për Ligjin Themelore të Punës në Kosovë, që paraqet akt normativ të karakterit procedural dhe material të aplikueshëm në këtë çështje juridike, me asnjë dispozitë nuk ka implikuar çështjen e procedurës dhe afateve të cilat duhet ndjekur nga i punësuar në rastet kur pretendon se i janë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës nga ana e punëdhënësit. Afatet e tilla janë normuar me Ligjin e Punës

Nr.03/L-212, respektivisht me dispozitat nga nenet 78 dhe 79 të këtij Ligji, mirëpo meqenëse ky ligj është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.11.2010, ndërsa në rastin konkret raporti juridik mes palëve ndërgjyqëse është krijuar në vitin kalendarik 2009, Gjykata vlerëson se dispozitat e të njejtit nuk mund të aplikohen dhe interpretohen në mënyrë retroaktive në kontekst të vlerësimit të afatshmërisë së paraqitjes së padisë. Thënë të gjitha këto, edhe në rast se do të gjenin aplikim dispozitat e lartëcekura, Gjykata vëren se vendimet mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, paditësit i kanë pranuar me dt.30.09.2009. Të njejtit ndaj këtyre vendimeve në mënyrë individuale kanë parashtruar ankesa me dt.09.10.2009, ndërsa lidhur me këto ankesa e paditura ka nxjerrë vendimet e dt.30.10.2009. Padia nga ana e paditësve në Gjykatë është parashtruar me dt.04.11.2009, që nënkupton se e gjithë procedura, duke e llogaritur nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës së paditësve (30.09.2009) e deri në momentin e ushtrimit të padisë (04.11.2009), rezulton që është konsumuar brenda periudhës kohore prej 45 ditësh. Mbi këtë bazë, një pretendim të tillë të palës së paditur Gjykata e vlerëson të pa themeltë.

Gjykata gjen se në nenin 3 të kontratave respektive të punës për secilin prej paditësve është përcaktuar se: *“Kontrata e punës mund të ndërprehet me kërkesën e punëtorit. Kërkesa për ndërprerjen e kontratës bëhet me paralajmërim së paku 30 ditë më herët. Ky afat nuk do të përfilllet nëse marrëdhënia kontraktuese e punës ndërpritet për shkak të shkeljes së detyrave të punës në rastet e përcaktuara me Ligjin Themelor të Punës në Kosovë dhe aktet normative të N Prishtina. Kjo kontratë mund të ndërprehet për shkak të ndryshimeve eventuale ekonomike, teknologjike ose strukturale në N Prishtina dhe në rastet e tjera të caktuara me dispozitat e Ligjit Themelor të Punës në Kosovë. Mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas kësaj baze, punëtori do të njoftohet me shkrim, në afati si në alinenë 2 të këtij neni.”*

Dispozita e lartëcituar nga neni 12 e Rregullores Nr.2001/27 për Ligjin Themelore të Punës në Kosovë, përcakton një nga mënyrat e shkëputjes së kontratës së punës, e që konsiston në shkëputjen e kontratës për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturore në ndërmarrje. Në rastin konkret, në bazë të provave të administruara, Gjykata erdhi në përfundim se e paditura nuk ka arritur ta argumentojë faktin se ka bërë ndryshime substanciale në prodhim, programim, organizim, strukturë dhe teknologji, ndryshime këto të cilat do të kërkonin dhe determinonin zvogëlim të numrit të punëtorëve, e po ashtu nuk e ka argumentuar faktin se ka ndërmarrë masa në drejtim të zbutjes së pasojave të shkaktuara nga ndryshimet me kalim në kompaninë e specializuar, duke mos ofruar dëshmi bindëse lidhur me të provuarit e faktit se të punësuarit - në rastin konkret paditësit janë informuar për ndryshimet në organizim dhe strukturim.

Nga elaborati mbi arsyeshmërinë ekonomike të angazhimit të një kompanie të jashtme për sigurimin e “N.P” Sh.a, i dt.24.10.2008, e cila provë sipas sugjerimeve të Gjykatës së Apelit është administruar në riprocedim, është përcaktuar që punët rreth sigurimit fizik të kalojnë në kompaninë e specializuar, ndërsa në të njejtin elaborat nuk është përcaktuar fare se në kuadër të këtyre ndryshimeve do të përfshihen edhe vozitësit e keshit, pozitë kjo në të cilën ishin të sistemuar paditësit deri në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Për më tepër, Gjykata vëren se edhe pas aprovimit të këtij elaborati nga ana e palës së paditur, e njejtja ka vazhduar me caktimin e punëtorëve në vendin e punës “...”, siç është rasti me 5 paditësit e parë, të cilët kanë lidhur kontrata të punës nga dt.01.07.2008, e po ashtu me paditësin e gjashtë G.D, me të cilin e paditura ka lidhur kontratë pune me dt.30.04.2009, pra më tepër se 1 vit pas aprovimit të elaboratit, përmes së cilit akt, pala e paditur pretendon se ka paraparë arsyeshmërinë për ndryshime - angazhimin e kompanisë së jashtme, e cila kompani do të

marrë përsipër kryerjen e punëve dhe detyrave për të cilat paditësit kanë pasur të lidhura kontrata të punës.

Në këtë mënyrë, fakti se e paditura ka lidhur marrëveshje me subjektin “B.I”, me objekt të marrëveshjes kryerjen e punëve të sigurimit të objekteve dhe të transportit të parave, sipas vlerësimit të Gjykatës nuk paraqet bazë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësve, për faktin se të njejtit nuk kanë qenë të angazhuar në sektorin e sigurimit të objekteve, por si vozitës të keshit. Në anën tjetër, marrëveshjes së lartëcekur, nuk i ka paraprirë ndonjë procedurë, e cila i përket ndryshimit organizativ apo strukturor të të paditurës.

Për më tepër, pala e paditur, me rastin e lëshimit të vendimeve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, nuk i është përmbajtur detyrimit të përcaktuar nga neni 3 i kontratës së punës për secilin prej paditësve, për faktin se vendimet e tilla janë përpiluar me dt.30.09.2009, ndërsa marrëdhënia e punës është ndërprerë me efekt nga data 01.10.2009, që nënkupton se nuk është respektuar afati i paralajmërimit prej 30 ditësh para ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Gjykata mori parasysh pretendimin e palës së paditur lidhur me faktin se neni 12 i Rregullores Nr.2001/27, nuk mund të gjejë zbatim në rastin konkret, për faktin se e njehta i referohet situatave kur kemi të bëjmë me largim nga puna në masë të gjerë. Në përgjigje ndaj këtij pretendimi, Gjykata vlerëson se fjalia e fundit e paragrafit 1 të kësaj dispozite, në pjesën: “*Në rastet kur për këtë arsye largohen nga puna të paktën 50 punonjës, konsiderohet se largimi nga puna është i shkallës së gjerë.*”, është e karakterit komplementar (plotësues) dhe asesi nuk mund të interpretohet se shërben vetëm në referim të situatave të largimit nga puna në shkallë të gjerë. Për më tepër, paragrafi 2 i të njejtës dispozite përcakton procedurën e cila duhet ndjekur në rastet e largimit nga puna në shkallë të gjerë, e cila është e një karakteri më specifik në krahasim me procedurat tjera. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se paragrafi 1 i nenit 12 të Rregullores Nr.2001/27 është gjithpërfshirës, pra i referohet të gjitha rasteve të shkëputjes së kontratës së punës për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale dhe nuk mund të interpretohet në mënyrë të shkëputur, siç i është referuar pala e paditur në pretendimet e parashtruara.

Si rezultat i arsyeve dhe rrethanave të elaboruara më sipër, qëndrimi dhe interpretimi i gjykatës së shkallës së parë konsiston në përfundimin se vendimet e të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për paditësit, respektivisht vendimet e shkallës së dytë me të cilat janë refuzuar ankesat e paditësve janë të përfshira me shkelje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, janë marrë në kundërshtim me dispozitën nga neni 12 të aktit normativ të aplikueshëm - Rregullores Nr.2001/27 për Ligjin Themelore të Punës në Kosovë dhe si të tilla duhet të anulohen. Mbi bazën e një konstatimi të tillë, Gjykata vendosi decidivisht si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Krahas vërtetimit të kundërligjshmërisë së vendimeve mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës për paditësit, të njejtit janë legjitimuar që të kërkojnë dhe kompensimin e të ardhurave dhe të drejtave tjera nga marrëdhënia e punës, të cilat të njejtit do t'i kishin realizuar nga marrëdhënia e punës për periudhën nga data 01.10.2009 - datë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, deri me datë 30.06.2011, datë kjo kur ka qenë e paraparë të përfundojë marrëdhënia e tyre e punës sipas fuqisë ligjore - me rastin e skadimit të kontratave të punës.

Në këtë drejtim, sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditësve, është caktuar nxjerrja e provës përmes ekspertizës aktuaristike, me ç'rast për ekspert është caktuar A.B. Eksperti i lartëcekur ka dhënë mendimin dhe konstatimin me shkrim me dt.25.07.2019, me ç'rast ka dhënë këto konstatime:

Në emër të pagave të pa paguara, kontributit pensional dhe tatimit në të ardhura gjatë periudhës kohore 01.10.2009 - 30.06.2011, e paditura duhet t'ua paguajë paditësve shumat si në vijim:

Paditësit R.C, në emër të pagave neto për periudhën kohore 01.10.2009 – 30.06.2011, shumën prej 7,431.00 € (shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e një euro), si dhe kamatës së arritur për pagesë për këto paga, duke e llogaritur nga data 04.11.2009, e deri me dt.15.07.2019, për normën si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar shumën prej 1,629.00 € (një mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë euro), apo shumën e përgjithshme prej 9,060.00 € (nëntë mijë e gjashtëdhjetë euro); Në emër të kontributit pensional, shumën prej 824.00 € (tetëqind e njëzet e katër euro), mjete këto të cilat duhet të transferohen në llogarinë personale të paditësit R.C në Trustin Pensional të Kosovës; Në emër të tatimit në të ardhura, shumën prej 401.00 € (katërqind e një euro), e cila shumë duhet të deklarohet pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

Paditësit SH.F, në emër të pagave neto për periudhën kohore 01.10.2009 - 30.06.2011, shumën prej 9,285.00 € (nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë euro), si dhe kamatës së arritur për pagesë për këto paga, duke e llogaritur nga dt.04.11.2009, e deri me dt.15.07.2019, për normën si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar shumën prej 1,956.00 € (një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro), apo shumën e përgjithshme prej 11,241.00 € (njëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e një euro); Në emër të kontributit pensional, shumën prej 1,032.00 € (një mijë e tridhjetë e dy euro), mjete këto të cilat duhet të transferohen në llogarinë personale të paditësit SH.F në Trustin Pensional të Kosovës; Në emër të tatimit në të ardhura, shumën prej 517.00 € (pesëqind e shtatëmbëdhjetë euro), e cila shumë duhet të deklarohet pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

Paditësit XH.O, në emër të pagave neto për periudhën kohore 01.10.2009 – 30.06.2011, shumën prej 9,285.00 € (nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë euro), si dhe kamatës së arritur për pagesë për këto paga, duke e llogaritur nga data 04.11.2009, e deri me dt.15.07.2019, për normën si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar shumën prej 1,956.00 € (një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro), apo shumën e përgjithshme prej 11,241.00 € (njëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e një euro); Në emër të kontributit pensional, shumën prej 1,032.00 € (një mijë e tridhjetë e dy euro), mjete këto të cilat duhet të transferohen në llogarinë personale të paditësit XH.O në Trustin Pensional të Kosovës; Në emër të tatimit në të ardhura, shumën prej 517.00 € (pesëqind e shtatëmbëdhjetë euro), e cila shumë duhet të deklarohet pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

Paditësit RR.B, në emër të pagave neto për periudhën kohore 01.10.2009 – 30.06.2011, shumën prej 9,345.00 € (nëntë mijë e treqind e dyzet e pesë euro), si dhe kamatës së arritur për pagesë për këto paga, duke e llogaritur nga data 04.11.2009, e deri me dt.15.07.2019, për normën si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar shumën prej 1,971.00 € (një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një euro), apo shumën e përgjithshme prej 11,316.00 € (njëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë euro); Në emër të kontributit pensional, shumën prej 1,039.00 € (një mijë e tridhjetë e nëntë euro), mjete këto të cilat duhet të transferohen në llogarinë personale të paditësit RR.B në

Trustin Pensional të Kosovës; Në emër të tatimit në të ardhura, shumën prej 522.00 € (pesëqind e njëzet e dy euro), e cila shumë duhet të deklarohet pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

Paditësit G.M, në emër të pagave neto për periudhën kohore 01.10.2009 – 30.06.2011, shumën prej 4,898.00 € (katërmijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë euro), si dhe kamatës së arritur për pagesë për këto paga, duke e llogaritur nga data 04.11.2009, e deri me dt.15.07.2019, për normën si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar shumën prej 1,094.00 € (një mijë e nëntëdhjetë e katër euro), apo shumën e përgjithshme prej 5,992.00 € (pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy euro); Në emër të kontributit pensional, shumën prej 537.00 € (pesëqind e tridhjetë e shtatë euro), mjete këto të cilat duhet të transferohen në llogarinë personale të paditësit G.M në Trustin Pensional të Kosovës; Në emër të tatimit në të ardhura, shumën prej 205.00 € (dyqind e pesë euro), e cila shumë duhet të deklarohet pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

Paditësit G.D, në emër të pagave neto për periudhën kohore 01.10.2009 – 30.06.2011, shumën prej 9,385.00 € (nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e pesë euro), si dhe kamatës së arritur për pagesë për këto paga, duke e llogaritur nga data 04.11.2009, e deri me dt.15.07.2019, për normën si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar shumën prej 1,981.00 € (një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një euro), apo shumën e përgjithshme prej 11,366.00 € (njëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro); Në emër të kontributit pensional, shumën prej 1,043.00 € (një mijë e dyzet e tre), mjete këto të cilat duhet të transferohen në llogarinë personale të paditësit G.D në Trustin Pensional të Kosovës; Në emër të tatimit në të ardhura, shumën prej 526.00 € (pesëqind e njëzet e gjashtë euro), e cila shumë duhet të deklarohet pranë Administratës Tatimore të Kosovës.

Ekspertizës së lartëcekur, Gjykata ia fali besimin e plotë në pikëpamje të vërtetimit të rrethanave dhe fakteve që kanë qenë të rëndësishme për vërtetimin e lartësisë së kërkesëpadisë së paditësve. E njehta është përpiluar në mënyrë profesionale, mbi bazën e të gjithë parametrave dhe standardeve të kërkuara dhe për më tepër të gjeturat e kësaj ekepertize nuk janë kontestuar nga palët ndërgjyqëse. Po ashtu, Gjykata e Apelit, në aktvendimin me të cilin e ka kthyer çështjen në rigjykim dhe rivendosje, nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje apo sugjerim në drejtim të të gjeturave të kësaj ekspertize.

Mbi bazën e rrethanave të lartëcekura, Gjykata vendosi decidivisht si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësve t’ua paguajë shumat e specifikuar në këtë pikë të dispozitivit. Me rastin e vendosjes, Gjykata mori në konsideratë dispozitën nga neni 2 par.1 të LPK-së, e cila përcakton: *“Në procedurë kontestimore gjykata vendosë brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse.”*

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, nga pika III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 452 par.1, 454 par.1 lidhur me nenin 463 par.1 LPK-së, duke e obliguar të paditurin që paditësve t’ua kompensojë shumën e tërësishme të shpenzimeve të nevojshme në këtë procedurë, sipas kërkesës së specifikuar dhe atë: shumën prej 4,892.80 Euro, të krijuara gjatë procedimeve të mëhershme, si dhe shumën prej 405.00 Euro, në emër të 3 seancave të mbajtura gjatë këtij procedimi, në shumën e përgjithshme prej 5,297.00 €.

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të dispozitës së nenit 142, lidhur me nenin 160 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL -
C.nr.6718/23, datë 11.06.2024

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 477 të LPK-së është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.